Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova
ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZRRUM

ZRRUM/UTM-03/05/2011
31 maj 2011

URDHËRESË PËR TARIFA SHËRBIMI

PËR PËRCAKTIM TË TARIFAVE TË SHËRBIMET PER GRUMBULLIM TË MBETURINAVE QË DUHET TË APLIKOHEN NGA KRM "HIGJIENA" Sh. A. GJILAN

Në pajtim me autoritetin e dhënë me *Ligjin Nr. 03/L-086*,datë 15 qershor *2008 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave* ("Ligji")

Konform me Nenin 28 të Rregullës mbi Rregullimin e Tarifave për Shërbime nga Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Kosovë të datës 12 gusht 2008 ("Rregulla e ZRRUM R 02/M"),

Në bazë të aplikacionit me shkrim të parashtruar nga KRM "Higjiena" Sh. A. Gjilan

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina ("ZRRUM") me autoritetin e vet nxjerr këtë Urdhëresë për Tarifa Shërbimi:

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit (UTSH), përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që i atribuohet Rregullës ZRRUM - R 02/M.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për KRM "Higjiena" Sh. A. Gjilan, që me këtë UTSH të veprojë me rastin e faturimit të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave që u ofron konsumatorëve të vet në tërë Zonën e Shërbimit.

3. Lista e Tarifave të Shërbimit

3.1 Për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave që iu ofron konsumatorëve të vet KRM "Higjiena" Sh. A. Gjilan, duhet të aplikojë tarifat e shërbimit të dhëna në Shtojcën 1, të kësaj UTSH-je.

3.2 Për shërbimet e pastrimit të rrugëve KRM "Higjiena" Sh. A. Gjilan, do të aplikojë

tarifat të cilat do të akordohen me procedurat dhe rregullat që i përcaktojnë Kuvendet Komunale të zonave përkatëse të shërbimit. Vlefshmëria e këtyre tarifave do të përcaktohet nga autoritet përkatëse komunale.

3.3 Për shërbimet tjera që kryen KRM "Higjiena" Sh. A., të cilat nuk janë përfshi nën pikat 3.1. dhe 3.2., faturimi do të bëhet me tarifat e kostove reale të përcaktuara nga kompania.

4. Afati

Tarifat e Shërbimit të aprovuara me anë të kësaj Urdhërese për Tarifa Shërbimi do të hyjnë në fuqi duke filluar nga: **1 qershor 2011 dhe do të vlejë gjerë me 31 maj 2012.**

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

5.1 KRM "Higjiena" Sh. A. Gjilan, do të shpërndajë Listën e Tarifave të Shërbimit të aprovuara me këtë UTSH tek secili Konsumatorë me rastin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose së paku një herë në vit bashkangjitur me Faturë.

5.2 Lista e Tarifave të Shërbimit e aprovuar nga ZRRUM nën këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit do të publikohet nga KRM "Higjiena" Sh. A. Gjilan në së paku në njërën prej gazetave ditore me tirazh gjithëpërfshirës në tërë Kosovën, brenda shtatë (7) Ditëve të Punës, pas dërgesës së UTSH-ve dhe publikimit të tyre në ueb-faqen zyrtare të ZRRUM-it.

Në këtë publikim, KRM "Higjiena" Sh. A. Gjilan, duhet të specifikojë qartë kategoritë dhe nën-kategoritë e konsumatorëve dhe në veçanti të përshkruajë në mënyrë detaje Zonën I dhe Zonën II të konsumatorëve komercial pasi që kanë tarifa të ndryshme.

6. Apelet

KRM "Higjiena" Sh. A. Gjilan, në rast të pakënaqësisë me dispozitat e kësaj UTSH-je ka të drejtë të apelojë tek Komisioni Shqyrtues që themelohet konform Ligjit, prej 15 ditë pune, nga dita e pranimit të kësaj UTSH-je.

7. Gjuha Zyrtare e Urdhëresës së Tarifave të Shërbimit

Kjo UTSH-ë nxjerrit dhe publikohet në tri (3) versione të shkruara, nga të cilat dy janë gjuhë zyrtare që përdoren në Kosovë, dhe atë: (i) Shqip, (ii) Serbisht, (iii) si gjuhë alternative Anglisht. Në rast të mospërputhjeve në mes të versioneve, do të mbizotërojë ai i gjuhës Shqipe.

.....
Raif Preteni
Drejtor i ZRRUM

SHTOJCA 1:

LISTA E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE

1. Kategoria e Konsumatorëve Shtëpiak		
Mënyra e ofrimit të shërbimit	Derë-me-derë	Me kontejnerë të përbashkët
Tarifa (EURO/muaj)	4.14	4.14

2. Kategoria e Konsumatorëve Komercial/Industrial			
2.1 Shërbimet e Ofruara me Kontejnerë të Përbashkët			
Nën-kategoria	**Nënkategoria 1** **Veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese** (kioska, kafe pjekëse-shitore, shitës të CD-eve dhe kasetave, argjendari, orëtar, agjenci turistike,avokatura,video-lojërat, video klub, internet kafe, rrobaqepës, këpucëtarë, dyqan fotografish, pastrim kimik, kozmetika, optika, gurë gdhendës, saraç-mbathtarë, zyra e inkasimit, përfaqësi të shoqatave, shitore suvenirësh, këmbimore, bastore e të ngjashme).	**Nënkategoria 2** **Veprimtaritë e vogla dhe të mesme komerciale** (butik, librari,auto larje, auto-parking, kurse të gjuhëve dhe IT- së, frizer meshkujsh dhe femrash, byrektore, ëmbëltore, shitore tekstili, shitore të auto-pjesëve, hekurishte, shitore sanitare, shitore të mobileve, shitore këpucësh, mishtore e specializuar, servile të ndryshme, shitore të ndryshme, objekte fetare të vogla, zyra të partive politike, farmaci, zyrat postare e të ngjashme)	**Nënkategoria 3** **Veprimtaritë e mesme dhe të mëdha komerciale, shërbyese dhe ato prodhuese** (furra të bukës, kateteri, gjellëtore, shitore ushqimore, podrume të pijeve, ambulanca private, xhamaprerës, ekspozitura të bankave, sallone të sanitarisë, sallone mobiliesh,qendrat sportive e të ngjashme)
Tarifa (Euro/muaj) Zona I-rë	4.83	8.71	16.21
Tarifa (Euro/muaj) Zona II-të	6.77	10.65	18.10
2.2. Shërbimet e Ofruara me Kontejnerë të Veçantë			
Vëllimi i kontejnerit	1.1 m3	5.0 m3	7.0 m3

Tarifa (EURO/zbrazje)	10.00	n/sh	n/sh

3. Kategoria e konsumatorëve Institucional			
3.1. Shërbimet e ofruara me kontejnerë të përbashkët			
Nën-kategoria	**Nënkategoria 1** (Zyra e partive politike, zyra postare, përfaqësi të shoqatave, objekte fetare e të ngjashme).	**Nënkategoria 2** (Shoqata, ambulanca, çerdhe, halla te sporteve, kinema, teatro, galeri e arteve, biblioteka, e të ngjashme).	**Nënkategoria 3** (Shkolla, posta, spitale, ministri, objekte te kuvendeve komunale, institucione financiare, institucione ndërkombëtare, qendra e studentëve, shtëpi botuese, shtypshkronja, poliklinika, gjykata, stacioni i autobusëve, stacioni i trenit e ngjashme)
Tarifa (EURO/muaj)	4.14	n/sh	n/sh
3.2. Shërbimet e Ofruara me kontejnerë të veçantë			
Vëllimi i kontejnerit	1.1 m3	5.0 m3	7.0 m3
Tarifa (EURO/zbrazje)	10.00	n/sh	n/sh

Vërejtje: Tarifa e përcaktuar sipas RPV`s së këtij procesi të datës, 4 maj 2011 , tabela nr. 10. Të hyrat e planifikuar nga shërbimi, kolona e tarifave mujore për konsumatorët shtëpiakë të shërbyer me **kontejner të përbashkët** është shënuar tarifa gabimisht 4.31 €/muaj e duhet të jetë si tarifa për konsumatorët e shërbyer derë me derë e përcaktuar në 4.14 €/muaj.

Prandaj, që të dy tarifat e **konsumatorëve shtëpiakë** dhe ata të **institucioneve të shërbyer me kontejner të përbashkët** përcaktohet tarifa prej **4.14 €/muaj.**

Shkurtes: n/sh nënkuptohet se nuk ofrohen shërbime për këtë grupim të konsumatorëve.